



Qendra per Karrier & Zhvillim Profesional

QKZHP

Top Education for Top Students



KONTAKTI!

UBT – University Education for Business and Technology

Add: Lagja Kalabria p.n., 10000

Web: www.ubt-uni.net

E-mail: career.center@ubt-uni.net

Phone: +381 38 541 400



Succeed with Quality!
100 % Internship

A good first step for your career

Qendra për Karrierë/Internship

Qendra për Karrierë dhe Internship në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë shërben si qendër e cila orienton dhe këshillon studentët të bëjnë ndërlidhjen e procesit akademik me tregun e punës dhe përvojën në praktikë profesionale dhe internship. Qendra ofron këshillime profesionale për studentë që nga dita e parë e fillimit të studimeve në UBT, duke ofruar trajnime profesionale në ngritje të shkathtësive të tyre si dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me aplikimin, përgatitjen e CV-ve, letrave motivuese, si dhe intervistimin, deri tek diplomimi dhe punësimi i tyre, me ç'rast mbanë evidenca mbi barometrin e punësimit të ish studentëve.

Qendra ju ofron ndihmë në këto fusha:

- **Internship**
- **Orientimi profesional**
- **Vizitat studimore**
- **Informacionet për studentët e ri**
- **Ish studentët -Alumni**
- **Programet e shkëmbimit**
- **Trajnimet profesionale dhe Certifikimet**

Internshipi

Internshipi në UBT do të vendos një bazë të mirë të bashkëpunimit të institucionit me firmat, kompanitë si dhe organizatat lokale dhe ndërkombëtare me qëllim që studentët të kenë mundësi punësimi dhe të fillojnë të mendojnë për karrierën e tyre.

Qendra ofron këto shërbime:

- Koordinimin e internshipit për studentët;
- Informimin e studentëve për mundësi internshipi dhe praktikë profesionale;
- Informimin e studentëve për konkurset dhe vendet e lira të punës;

Orientimi Profesional

Qendra për Orientim në Karrierë dhe Internship ka për qëllim që të ofroj qasje të drejtë për studentët të cilët dëshirojnë të kenë një karrierë të suksesshme, e cila ju mundëson punësim të mirë dhe të shpejtë.

Qendra ofron këto shërbime:

- Orientimi i studentëve për programet e studimit;
- Orientimi i studentëve në fillimin e karrierës
- Orientimi i studentëve si të ndërlidhin teorinë me praktikën;

Vizitat Studimore

Vizitat studimore janë një komponent i rëndësishëm për studentët e UBT-së, të cilat e ndërlidhin të mësuarit akademik me të mësuarit në bazë të aktiviteteve. Qendra për Orientim në Karrierë dhe Internship i ofron përkrahje departamenteve në realizimin me sukses të këtyre vizitave studimore brenda dhe jashtë vendit.

- Vizita studimore në institucione dhe kompani në nivel vendi;
- Vizita studimore në institucione dhe kompani jashtë vendi;

Alumni

Rrjeti i ish studentëve (Alumni) është në funksion të zhvillimit dhe avancimit të procesit mësimor dhe jashtë kurrikular në UBT, si një aset i domosdoshëm dhe i veçantë. Alumni do të jenë prezent me sukseset e tyre në ofrimin e përvojave dhe arritjeve profesionale për studentët e rinj që edhe ata të kenë një ndërlidhje të suksesshme me tregun e punës.

Alumni do të:

- Ftohën rregullisht në konferenca shkencore, seminare, trajnime, si dhe ligjërata publike;
- Shpall konkurse për projektin më të mirë të Alumni për vitin 2013;
- Alumni do të njoftohet përmes adresës;
- Alumni Day- ku Universiteti i mirëpret Alumnit;
- Aktivitete të tjera.

Trajnimet Profesionale / Certifikimet

Gjatë kohës së studimeve UBT do të ofroj trajnime të ndryshme të cilat janë të rëndësishme për ngritjen e tyre profesionale. Trajnimet janë të natyrës objektive dhe i përgatisin studentët për karrierën e tyre në të ardhmën.

Në kuadër të trajnimeve profesionale hyjnë:

- Trajnimet e TOEFL/IELTS
- Trajnimi në menaxhimin e projekteve;
- Trajnimi për përgatitjen e CV-ve dhe letrave motivues e;
- Trajnimet në fushën e biznesit, ekonomisë si dhe trajnimet tjera;
- Certifikimet